

# Love City Story Lesbiket

Sipas lesbikes T.M., për shkak të mentalitetit patriarkal të shoqërisë, jeta e tyre në Prishtinë është një ferr i vërtetë. "Për shkak të rregullave shoqërore, shumica e femrave me përcaktim të këthillë seksual, i fshehin ndjenjat e tyre dhe në fund vendosin të martohen me meshkuj"

MJELLMA PALLASKA Mitrovicasja T.M. (25) jeton në Prishtinë. Asaj i pëlqen muzika, filmat, librat, udhëtimet... Pra, në dukje të parë ajo është një femër e zakonshme, por orientimi i saj seksual e bën të dallojë nga shumica e femrave. "Mentaliteti në Prishtinë dhe tentimi që ta bindi këtë shoqëri, se orientimin seksual nuk e kam zgjedhë, por nuk kam zgjedhje tjetër, më shkakton lodhje. Nuk mund ta ndërroj veten". Sipas T.M. (identiteti i saj i njohur për

redaksinë), për shkak të mentalitetit patriarkal të shoqërisë, jeta e lesbikeve në Prishtinë është një ferr i vërtetë. "Për shkak të rregullave shoqërore, shumica e femrave me përcaktim të këthillë seksual, i fshehin ndjenjat e tyre dhe në fund vendosin të martohen me meshkuj". Ajo thotë se në fillim ka qenë më e vendosur në qëndrimin e saj dhe prezantimit në shoqëri, por ka hasur në reagime

të ndryshme negative. "Njerëzit në rrugë të ngacmojnë dhe të shajnë. Prandaj kam vendosur të jejoj në mënyrë më diskrete dhe mos të ekspozohem. Kam kuptuar se kjo shoqëri nuk është në gjendje ta kuptojë një realitet të tillë. Të njëjtin problem e kam edhe me familjen time, e cila nuk mund ta pranojë këtë fakt". T.M. thotë se gjithmonë ka pasur simpati të veçantë për femrat. Si 17-vjeçare, ka qenë e dashuruar në një djalë të klasës, por është dëshpëruar. "Duket se ai nuk më ka dashur

kurrë. Vetëm një natë kam qenë me të. Më ka zhgënjyer dhe prej atëherë kurrë nuk kam qenë me një mashkull". Ajo tash është në lidhje dashurie me një femër nga Gjakova, 18-vjeçaren A.Z. "Kalojmë shumë mirë dhe kuptohemi mes vete". Nga viti 2001 në Prishtinë ekziston shoqata e lesbikeve "Safo", e cila funksionon gjysmëlegjalisht. Shumë lesbike nuk e dinë selinë e organizatës që duhet të mbrojtë të dëfjitat e tyre, sepse udhëheqëset e saj dëshirojnë që shoqatën ta mbajnë sa më larg syve të opinionit. Sociologjia Linda Gusia thotë se shoqëria kosovare, si çdo shoqëri tjetër patriarkale, është homofobike. "Kjo shoqëri e gjykon këtë fenomen si amoral dhe jonormal, prandaj lesbiket i konsideron si femra të marginalizuara. Shoqëria këtë orientim seksual e konsideron si sëmundje. Gjithçka që del nga rregullat famil-

jare, për këtë shoqëri nuk është normale. Orientimi seksual hyn në të drejtat elementare të njeriut dhe e drejtë e çdo njeriu është ta zgjedhë orientimin seksual", thotë Gusia. Kurse Igballë Rugova, udhëheqëse e Rrjetit të Grave Kosovare, thotë se misioni i kësaj organizate është që të përkrahë dhe mbështes paratësit nga vajzat pavarësisht nga bindjet e tyre politike, fetare, nivelit të edukimit, apo orientimit seksual. Ndërsa Ibrahim Makolli, zyrtar në KMDNJ, thotë se shoqëria kosovare ende nuk është treguar e gatshme ta konceptojë lesbikizmin.

"Me norma ndërkom-betare përcaktimi seksual është e drejtë e secilit. Pra edhe lesbiket do të duhej t'i gëzojnë të drejtat e tyre lirisht". Arjeta Rexha, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës për Trajnime dhe Studime Gjinore, thotë se kjo qendër asnjëherë nuk është marrë me këtë dukuri. Por, sipas saj, orientimi seksual i femrave është e drejtë e tyre, e cila nuk reflekton negativisht në shoqëri. "Vetë fakti që nuk flitet për lesbizmin, tregon se kjo dukuri ka filluar të pranohet në shoqërinë kosovare".

## Femrat publike lesbike

T.M. thotë se një disa femra nga jeta publike dhe estrada, që janë lesbike. "Janë 3-4 këngëtare të njohura që bëjnë dashuri me femra. Por, një edhe femra të tjera lesbike, të cilat vijnë nga skena e artit, punëtore të institucioneve dhe nga skena politike. Për dallim nga meshkujt homoseksualë, shumica e të cilëve për ta fshehur biseksualizmin janë martuar me femra, femrat lesbike janë të pamartuara".



Foto: R. Rugova